



GRUPI PËR TË DREJTAT THEMELORE
DHE SUNDIMIN E LIGJIT

Raport mbi vizitën në Shqipëri Konstatimet e autoriteteve mbi raportin

2-3 prill 2025



Komiteti Ekonomik
dhe Social Evropian

Raport mbi vizitën në Shqipëri
2-3 prill 2025



Fundamental Rights and the Rule of Law

Raport mbi vizitën në Shqipëri

2-3 prill 2025

Pesë anëtare të KESE-s morën pjesë në vizitën në Shqipëri. Delegacioni u takua me disa përfaqësues të të gjithë spektrit të shoqërisë civile, më konkretisht, me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), partnerëve socialë, medias dhe profesioneve ligjore, sipas rregullave "Chatham House". Qëllimi i këtij raporti është të pasqyrojë dhe të portretizojë me përpikëri pikëpamjet e shoqërisë civile. Delegacioni u takua gjithashtu me përfaqësues të qeverisë, të cilët do të japin konstatimet e tyre.

1. Të drejtat themelore të partnerëve socialë

Sipas pjesëmarrësve, **dialogu social** është i dobët dhe tejet jofunksional, si dhe nevojitet trajnim dhe ngritje e kapaciteteve. Sipas pjesëmarrësve, Këshilli Kombëtar i Punës (KKP), i cili ka mandatin ligjor për t'u mbledhur në mënyrë periodike, është mbledhur vetëm një herë në vit, kryesisht falë nxitjes nga BE-ja. Njëzet e një persona mund të krijojnë ligjërisht një sindikatë. Ndryshe nga sindikatat, për organizatat e punëdhënësve nuk kishte kërkesa të qarta për të vërtetuar përfaqësimin. Sindikatat u shprehën se dëshironin ta transformonin KKP-në dhe Këshillin Ekonomik Kombëtar në një këshill të vetëm të quajtur Këshilli Ekonomik dhe Social, pasi mes tyre ka mbivendosje për shumë çështje, çka shpeshherë rezultoi në mosmarrjen në konsideratë të rekomandimeve të KKP-së. Sipas pjesëmarrësve, ka pak ose aspak konsultime reale për politikën e punës, duke përfshirë për vendimet kritike mbi pensionet dhe pagën minimale. Në disa raste politikën njoftohen pa u konsultuar, përmes medias. Autoritetet shqiptare u shprehën se takimet e KKP-së janë mbajtur duke përdorur një proces transparent dhe se KKP-ja ka publikuar raporte të rëndësishme, në veçanti për rritjen e pagës minimale.

Sipas sindikatave, e **drejta e grevës**, edhe pse mbrohet me kushtetutë, shpeshherë është cenuar. Grevat janë penguar nga proceset e gjata të ndërmjetësimit. Gjithashtu, është përmendur se punëdhënësit shpeshherë janë hakmarrë ndaj organizatorëve të sindikatave duke i pushuar nga puna ose duke i hedhur në gjyq, çka ka rezultuar në veprime joefektive të lidhura me punën. **Niveli i pjesëmarrjes në sindikata** ka vijuar të jetë shumë i ulët dhe sipas pjesëmarrësve, organizimet në sektorin publik dhe privat janë penguar nga ndërhyrjet direkte, si p.sh., në disa raste, caktimi në mënyrë të njëanshme i përfaqësuesve të sindikatave nga nëpunësit publikë. Për më tepër, prania e sindikatave të rreme ka cenuar veprimtaritë e sindikatave legjitime. Edhe pse ekzistojnë disa kontrata kolektive, ka të tjera që janë fiktive, dhe shumica nuk zbatohen në praktikë. Pjesëmarrësit përmendën problemet me një numër të lartë të aksidenteve në vendin e punës, por Inspektorati i Punës ka burime të kufizuara. Autoritetet shqiptare pranuan vështirësitë e lidhura me ngritjen e sindikatave në shoqëritë private dhe përmendën përpjekjet për të nxitur kontratat kolektive.

Nuk kishte një histori të gjatë të dialogut social dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e bizneseve ishin anëtarë të një shoqate të punëdhënësve. Pavarësisht këtyre vështirësive, punëdhënësit angazhoheshin në mënyrë aktive në strukturat e dialogut social pranë KKP-së. Pjesëmarrësit përmendën se, si pasojë e mungesës së kapaciteteve, punëdhënësit kishin vështirësi në zbatimin e legjislacionit për punën dhe të rregullave të tjera të BE-së. Punëdhënësit shprehën shqetësime mbi barrën tatimore, **korruptionin dhe konkurrencën e padrejtë**, në veçanti favorizimin e bizneseve me lidhje të ngushta me qeverinë. Punëdhënësit shpjeguan se bashkëpunonin me OShC-të për të luftuar korruptionin. Punëdhënësit ishin ftuar që të jepnin komente mbi legjislacionin, por e kishin pasur të vështirë të jepnin komente mbi një gamë të gjerë të fushave ligjore si pasojë e kapaciteteve të kufizuara, dhe rrallëherë njoftoheshin nëse komentet e tyre ishin marrë ose jo në konsideratë. Gjithashtu, pjesëmarrësit shprehën shqetësime mbi mospërputhjen e aftësive, eksodin e punonjësve të rinj, infrastrukturën e dobët digjitale dhe problematikat e tjera ekonomike, si punësimi informal në zonat rurale dhe mungesa e mjeteve financiare.

Problematikat e lidhura me sundimin e ligjit, të cilat janë përmendur në Raportin e Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit për Shqipërinë 2024, kanë prekur edhe partnerët socialë. Aksesit në drejtësi përbente sfidë, si pasojë e numrit të konsiderueshëm të çështjeve të prapambetura dhe mungesës së një gjykate të posaçme për çështjet e lidhura me punën. Punonjësit nuk kishin zgjidhje efektive ligjore në rastet e largimit të padrejtë nga puna, pasi procedurat në gjykatë mund të zgjasin deri në 10 vite, duke u mohuar kështu zgjidhjet ligjore efektive.

2. Liria e organizimit dhe liria e tubimit

Sipas pjesëmarrësve, OShC-të në Shqipëri janë përballur me shumë sfida në drejtim të **pjesëmarrjes kuptimplotë në vendimmarrje**. Ata konstatojnë se shpeshherë institucionet publike nuk kanë siguruar të dhëna apo komente të mjaftueshme mbi kontributet e OShC-ve duke e bërë të vështirë për këto të fundit që të kontribuojnë në mënyrë efektive. Është prezantuar një **platformë e re për konsultimin e OShC-ve**, por pjesëmarrësit përmendën se OShC-të nuk ishin konsultuar përpara ngritjes së platformës dhe se nuk kishte njohuri të gjera mbi këtë platformë. Pas publikimit të një konsultimi, grupet e interesit kishin 30 ditë kohë për të dhënë kontributin e tyre, por shpeshherë OShC-të informoheshin shumë vonë për mundësitë e konsultimit, kontributi i tyre rrallëherë pasqyrohej në politikat përfundimtare dhe niveli i ndjekjes ishte minimal. Sipas pjesëmarrësve, strategjitë për energjinë dhe klimën ishin shembuj të rasteve ku masat e ndjekjes mund të përmirësoheshin.

Procesi i integritetit në BE krijoi një shtysë për përmirësimin e pjesëmarrjes së OShC-ve, pasi qeveria synon të mbyllë të gjithë kapitujt e bisedimeve për anëtarësimin në BE brenda vitit 2027. Megjithatë, OShC-të ndiheshin se po përsërisnin të njëjtat shqetësime në konsultime dhe shihnin një nivel të ulët progresi thelbësor. Gjithashtu, OShC-ve u **mungonin kapacitetet** për të marrë pjesë në të gjitha konsultimet ku ishin ftuar. Ekzistonin rrjete informale të OShC-ve në sektorë të tillë si rinia, mjedisi dhe sundimi i ligjit, por koordinimi horizontal ishte i vështirë për t'u ruajtur. Ekzistonin shembuj të mirë të rrjeteve rurale dhe të grave.

Shumë prej OShC-ve përballeshin me **pengesa ligjore dhe financiare**, duke përfshirë vështirësi në regjistrim, mospërfundim nga TVSH-ja dhe auditime shtetërore të vështira/mundimshme. Gjithashtu, pjesëmarrësit përmendën fushatat e shpifjes kundër OShC-ve, të cilat cenonin besimin e publikut tek to, duke ndikuar kështu në besueshmërinë e tyre dhe kapacitetin për të vepruar. Pjesëmarrësit ndanë

shqetësime lidhur me zvogëlimin e hapësirës së veprimit të shoqërisë civile, veçanërisht që nga pandemia e COVID-19. Nuk ekzistonte një përkufizim ligjor apo kuadër mbrojtjeje për advokuesit në favor të të drejtave të njeriut. Autoritetet shqiptare u përgjigjen se gjatë katër viteve të fundit kishin zbatuar dy udhërrëfyes për të krijuar një mjedis mundësues për OShC-të dhe po merrnin masa për të miratuar një udhërrëfyes të tretë.

Ofrimi i shërbimeve sociale varej ndjeshëm nga OShC-të, por pa financim nga donatorët e huaj, shumica e tyre rrezikonin të mbylleshin. OShC-të rekomanduan rritjen e financimeve të drejtpërdrejta nga BE-ja për OShC-të në vend të situatës aktuale të kalimit të fondeve përmes autoriteteve vendore. **Varësia nga donatorët** përbënte një sfidë për të gjitha OShC-të me financime të bazuara në projekte, çka rezultoi në veprimtari advokimi të fragmentuara. Financimi për veprimtaritë bazë ka qenë minimal dhe shumë grupeve u mungonte kapaciteti administrativ për të zbatuar procedurat komplekse të nëndhënies së granteve të BE-së dhe për të zhvilluar ekspertizën. Ka qenë e vështirë të përfitohej financim për organizatat mbikëqyrëse. Krahës mungesës së financimit, organizatat për të rinjtë kanë hasur vështirësi lidhur me përjashtimin strukturor dhe mundësitë e kufizuara për angazhim. Në veçanti, ndryshimet në politika, të miratuara nga qeveria e SHBA-së, kanë zvogëluar financimin për organizatat që merren me çështjet e komunitetit LGBTIQ+ dhe të drejtat e grave. Autoritetet shqiptare janë shprehur se janë në dijeni të nevojës për më shumë financim.

Pjesëmarrësit shpjeguan se, pavarësisht progresit drejt integritetit në BE, ky proces vazhdon të jetë i strukturuar kryesisht nga lart-poshtë, dhe shpesh OShC-të trajtohen si instrumente dhe jo si partnerë realë. Nevojiten përmirësime strukturore afatgjata në aspektet e konsultimit, financimit dhe besimit.

3. Liria e shprehjes dhe liria e medias

Pjesëmarrësit u shprehën se **pronësia e mediave ishte tejet e përqendruar**, pasi shumica e kanaleve mediatike drejtohen nga aleatët politikë të qeverisë, ndërsa një përqindje e vogël janë të lidhura me opozitën. Sipas pjesëmarrësve, disa konglomerate të zotëruar nga familje kanë marrë subvencione jo transparente dhe fonde për reklama publike, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e stafit të mediave publike përbëhet nga ish-zëdhënës të partive politike. Autoritetet shqiptare u janë përgjigjur këtyre shqetësimeve duke deklaruar se po monitorojnë pronarët përfitues të kanaleve mediatike për të luftuar përqendrimin e mediave.

Besimi i publikut te media është cenuar nga skandalet, si p.sh. dënimi për korrupsion i ish-drejtorit të përgjithshëm të transmetuesit publik të Shqipërisë (RTSH), si dhe **mungesa e lëvizjes së lirë të informacionit**, pasi gjithnjë e më tepër politikanët po anashkalojnë median tradicionale dhe po përdorin kanalet e mediave sociale. Pjesëmarrësit mendojnë se Agjencia për Media dhe Informim funksionon më tepër si një departament i marrëdhënieve me publikun i qeverisë se sa si një ofrues informacioni.

Këshilli Shqiptar i Medias ka propozuar udhëzime për **sjelljen etike të medias**, por rekomandimet e tij janë injoruar. Sipas pjesëmarrësve, qeveria ka përdorur përpjekjet e dështuara për vetërregullimin e sektorit si një justifikim për të ndërhyrë. Pjesëmarrësit u shprehën se këto dështime janë pjesërisht të vërteta dhe se autoriteteve audiovizive të ngarkuara për monitorimin e standardeve u mungon pavarësia dhe besueshmëria. Konsultimi me OShC-të lidhur me rregullimin e medias është parë shpeshherë si joefektiv, pasi shqetësimet e OShC-ve janë injoruar ose keqinterpretuar. Një përpjekje e qeverisë për të reformuar legjislacionin për mediat, e cila përmbante rrezikun e censurimit, u tërhoq vetëm pasi u

kritikua nga Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës. Më pas, autoritetet shqiptare iu përgjigjën kësaj çështjeje duke deklaruar se mbështesnin vetërregullimin dhe se po vijonin reformat.

Është miratuar një **mbyllje e TikTok-ut** për një vit si masë për mbrojtjen e fëmijëve, por nuk janë organizuar konsultime publike apo debate parlamentare përpara miratimit të mbylljes. Pjesëmarrësit u shprehën se shumë besojnë se mbyllja e TikTok-ut kishte motive politike, me shumë mundësi të lidhura me zgjedhjet e vitit 2025 dhe praninë e dobët të qeverisë në këtë platformë krahasuar me platformat e tjera. Sipas raportimeve, janë përdorur fonde publike për të “fryrë” angazhimin në llogaritë jopublike në media sociale.

Sipas pjesëmarrësve, gazetarët kanë pasur pak hapësirë për të bërë pyetje kritike apo për të sfiduar narrativat zyrtare. Shpifja vijon të konsiderohet krim dhe janë përdorur **paditë strategjike ndaj pjesëmarrjes së publikut (SLAPP)**, fushatat e shpifjes dhe forma të tjera të intimidimit/kanosjes për të goditur ata pak gazetarë të pavarur që kanë mbetur. Sipas pjesëmarrësve, në vitin 2023 janë depozituar disa padi kundër gazetarëve. Gazetarët nuk kanë pasur akses të lirë në ndihmë juridike dhe janë mbështetur në platformat evropiane për të marrë ndihmë, çka i ka bërë ata tejet të cënueshëm ndaj presionit dhe vetëcensurimit. Edhe pse sulmet fizike dhe dënimet kanë qenë të rralla, nuk ka mekanizma mbrojtjeje të besueshëm për të garantuar **sigurinë e gazetarëve**. Sipas pjesëmarrësve, konsultimet mbi sigurinë, të mbajtura në mars të vitit 2024, kanë shënuar një hap të vogël pozitiv, por besimi në zbatimin e ligjit mbetet i ulët. Proceset ligjore kanë qenë shumë të ngadalta dhe shpeshherë, prokurorët nuk kanë pasur burimet apo autoritetin për të hetuar në mënyrë efektive **ngacmimin dhe fushatat e shpifjeve online**. Autoritetet shqiptare janë përgjigjur se jo të gjitha çështjet gjyqësore lidheshin me paditë SLAPP, por konfirmuan vonesat në proceset gjyqësore duke ja atribuar këtë fakt mungesës së gjyqtarëve. Autoritetet shqiptare nënvizuan bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe gjyqësorit, si dhe praninë e pikave të posaçme të kontaktit për t’iu përgjigjur kërcënimeve ndaj gazetarëve.

Sipas pjesëmarrësve, **shkeljet e të drejtave të punës** janë të përhapura në sektorin e medias. Shpeshherë, gazetarët janë pjesë e punësimit joformal dhe punëdhënësit nuk u paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore. Ekzistojnë tre shoqata të gazetarëve dhe një sindikatë e krijuar rishtazi, por sipas pjesëmarrësve, të gjitha këto struktura janë të dobëta dhe nuk arrijnë të mbrojnë sa duhet gazetarët.

Është ngritur një komision i posaçëm (ad hoc) për të zhvilluar një strategji kombëtare kundër **dezinformimit**. Pjesëmarrësit besojnë se është përdorur informacion i pasaktë apo kontradiktor si mjet për të ndikuar perceptimin e publikut në favor të personave në pushtet dhe se pjesa më e madhe e dezinformimit vjen nga aktorë të brendshëm. Megjithatë, është rritur cënueshmëria e Shqipërisë ndaj ndikimit të jashtëm si pasojë e kapacitetit të dobët të mediave në vend. Mediat vendore nuk kanë qenë në gjendje të filtrojnë dhe analizojnë zhvillimet globale dhe dobësimi i burimeve të pavarura ka krijuar një boshllëk që po mbushet gjithnjë e më tepër nga narrativat ruse apo kineze.

4. E drejta për mosdiskriminim

Pjesëmarrësit nënvizuan progresin në legjislacionin për të drejtat e njeriut dhe në luftën kundër diskriminimit, por theksuan se niveli i zbatimit mbetet i dobët, duke rezultuar në mbrojtje të pamjaftueshme për komunitetet e cënueshme. Pjesëmarrësit shprehën shqetësime lidhur me **mungesën e mbështetjes për institucionet dhe OShC-të që punojnë për mbrojtjen nga diskriminimi**, dhe në veçanti, lidhur me presionin që vjen nga e djathta ekstreme kundër OShC-ve që merren me të drejtat e grave dhe çështjet e komunitetit LGBTIQ+. OShC-të janë përpjekur të angazhohen me qeverinë kundër

krimeve të urrejtjes, por pa sukses. Sipas pjesëmarrësve, dënimi minimal prej dy vitesh për krimet e urrejtjes ishte shumë i lartë dhe shpeshherë, gjyqtarët i konsideronin këto dënime si jo në përputhje me shkeljen, çka rezulton në mungesë dënimi.

Gjithashtu, sipas pjesëmarrësve, **të drejtat e grave** mbroreshin me ligj, por ka mangësi në zbatim. Organizatat e grave nuk kanë financime të qëndrueshme, çka kufizon aftësinë e tyre për kryerjen e veprimtarive të advokimit dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Ndërkohë, normat e dëmshme sociale dhe mungesa e edukimit për çështjet gjinore kanë vijuar të përforcojnë pabarazinë gjinore. Edhe pse Shqipëria ka miratuar ligje kundër dhunës me bazë gjinore, të mbijetuarat kanë hasur vështirësi për të aksesuar ndihmën juridike dhe për të marrë urdhra mbrojtjeje në kohë. Pjesëmarrësit u shprehën se janë shtuar retorikat kundër grave dhe përpjekjet për të kufizuar të drejtat e grave, veçanërisht në periudhën para zgjedhjeve të vitit 2025. Advokuesit në favor të të drejtave të grave janë akuzuar se kanë cenuar vlerat tradicionale të familjes dhe janë bërë subjekt i një numri në rritje të sulmeve online, ndërkohë që OShC-të kanë shfaqur frikë për sigurinë e stafit të tyre. Pjesëmarrësit shpjeguan se, gjatë konsultimeve rreth një projektligji për surrogacinë, grupe fetaret ishin shfaqur me fëmijë kukulla, kishin filmuar pjesëmarrësit e OShC-ve dhe i kishin postuar online fotot e tyre. Gjithashtu, u përhapën thashetheme të rreme se ligji ishte i nxitur nga komuniteti LGBTIQ+. Pjesëmarrësit sugjeruan që rekomandimet e Bashkimit Evropian të trajtojnë sulmet online, diskriminimin e shumëfishtë (ndërsektorialiteti) dhe një kuadër llogaridhënieje.

Individët nga komuniteti LGBTIQ+ janë përballur me diskriminim masiv, ndërkohë që martesat brenda të njëjtës gjini nuk njihen me ligj. Edukimi seksual karakterizohet nga ndasitë gjinore dhe kurrikula arsimore nuk paraqet në mënyrë objektive çështjet e komunitetit LGBTIQ+, çka kontribuon në rritjen e nivelit të braktisjes së shkollës së mesme dhe përjashtimin e personave nga komuniteti LGBTIQ+. Sipas pjesëmarrësve, një fushatë kundër bullizmit e realizuar disa vite më parë solli reagime negative dhe që nga ajo kohë, qeveria e ka ulur nivelin e reagimit. Personat nga komuniteti LGBTIQ+ janë përballur me sfida lidhur me aksesin në punësim, strehim dhe shërbime sociale. Ekziston një protokoll kombëtar për shërbimet shëndetësore për transgjitorët, por nuk është vënë në zbatim, ndërkohë që kriminalizimi i punës seksuale ka përshkallëzuar cenueshmërinë e punonjësve të seksit transgjitorë. Pjesëmarrësit konstatuan se nuk ofrohej strehim i veçantë për të rinjtë LGBTIQ+ dhe se personat LGBTIQ+ në konflikt me ligjin mbaheshin në qeli së bashku me personat që i diskriminonin. Individët nga komuniteti LGBTIQ+ përballeshin gjithashtu me gjuhë urrejtjeje online dhe dezinformim.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e **Romëve dhe Egjiptianëve** në Republikën e Shqipërisë (2021-2025) është karakterizuar nga mungesa e kapacitetit dhe burimeve, çka ka penguar zbatimin e planit. Sipas pjesëmarrësve, niveli i arsimimit në këtë komunitet është ulur gjatë kohështrirjes së planit dhe sipas vlerësimeve, më tepër se gjysma e grave romë nuk dinë shkrim-lexim. Fëmijët romë kanë vuajtur nga veçimi në shkolla dhe mungesa e aksesit në arsim cilësor. Madje, sipas pjesëmarrësve, ka pasur disa shkolla pa akses në ujë të pijshëm. Pavarësisht se veçimi në shkolla është një çështje që dënohet ndërkombëtarisht dhe pavarësisht faktit që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka kritikuar situatën, nuk është marrë asnjë masë konkrete. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka rezultuar një program punësimi artificial që nuk ka arritur të krijojë punësim formal për këtë komunitet. Pjesëmarrësit nënvizuan problematikat me antixhipsizmin, rritjen e nivelit të diskriminimit online dhe mungesën e aksesit në shëndetësi dhe strehim.

Personat me aftësi të kufizuara janë përballur me diskriminim lidhur me aksesin në punësim, kujdes shëndetësor dhe pjesëmarrjen e publikut, duke përfshirë në votim. Sipas pjesëmarrësve, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) nuk është zbatuar siç duhet, në veçanti neni 12 për njohjen e barabartë përpara ligjit dhe neni 13 për aksesin në organet e drejtësisë. Pjesëmarrësit konstatuan se personat me aftësi të kufizuara psiko-sociale kishin kufizime ligjore në të drejtën për të votuar dhe se institucionet publike dhe private vazhdonin të mos përmbushnin në një masë të madhe detyrimet e lidhura me aksesueshmërinë. Arsimi cilësor ishte i vështirë për t'u aksesuar ndërkohë që shërbimet e asistencës personale ishin pothuajse inekzistente dhe shpeshherë, nënat ishin të detyruara ta ofronin vetë kujdesin e nevojshëm. Niveli i ofrimit të shërbimeve sociale ishte tejte i ulët. Pagesa për aftësinë e kufizuar ishte e ulët dhe jepej në përputhje me kritere dhe vlerësime jo transparente. Nëse dënoheshin me burgim për një krim, personat me sëmundje mendore mbaheshin në burgje të zakonshme, në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pjesëmarrësit përmendën se **të drejtat e fëmijëve** ishin të lidhura ngushtësisht me pabarazinë gjinore dhe rekomanduan fuqizimin e nënave. Sistemi i kujdestarisë ka mbetur i pazhvilluar, çka ka sjellë efekte të fëmijët e rritur në institucione, ndërsa **emigrantët** e mitur të pashoqëruar janë përballur me mangësi ligjore dhe institucionale, të cilat kanë rezultuar në mungesë aksesin në arsim cilësor. Dhuna ka vijuar të jetë e pranishme në shkolla dhe në shtëpi dhe sistemet e kujdesit kanë ofruar vetëm zgjidhje afatshkurtra, ndërkohë që vijnë të mungojnë shërbimet afatgjata. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve, si p.sh. linjat telefonike të ndihmës, ekzistojnë, por nuk janë përdorur shumë dhe kanë mungesë fondesh. Për më tepër, pjesëmarrësit përmendën problemet me trafikimin, duke përfshirë shfrytëzimin e emigrantëve dhe të azilkërkuesve. Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, e cila trajton në mënyrë specifike trafikimin e paligjshëm, është drejt fundit, megjithatë shumë prej objektivave të saj nuk janë përmbushur ende.

Pjesëmarrësit përmendën mungesën e koordinimit në nivel qeverie lidhur me luftën kundër diskriminimit dhe theksuan se Parlamenti nuk ka zëvendësuar ende **Avokatin e Popullit, mandati i së cilës ka përfunduar**. Pjesëmarrësit besojnë se në procesin e përzgjedhjes ekzistojnë mundësitë për ndërhyrje politike. Moscaktimi i Avokatit të ri të Popullit rrezikon të dobësojë nivelin e besimit. Pjesëmarrësit rekomanduan që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ndërmarrë veprime më proaktive për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në takimin vijues me delegacionin, autoritetet shqiptare u shprehën se po planifikonin të krijojnë një fond social në vitin 2025 për të lehtësuar aksesin në punësim, duke përfshirë për personat me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët, si dhe konstatuan se po merrnin hapa për të zbatuar më tej KDPAK-në.

5. Sundimi i ligjit

Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar sundimin e ligjit përmes Agjendës Kombëtare të Reformave 2024–2027, si dhe përmes Udhërrëfyesit të vitit 2023 për Shtetin e së Drejtës dhe Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike. **Pavarësia e pushtetit gjyqësor** është forcuar formalisht, por mbetet ende e brishtë në praktikë. Një numër i madh gjyqtarësh janë larguar nga puna përmes një procesi vetingu që synonte forcimin e pavarësisë dhe kompetencës së pushtetit gjyqësor. Megjithatë, kanë vijuar mangësitë në aspektin e llogaridhënies. Procedurat disiplinore kanë qenë jo transparente dhe sipas raportimeve, disa gjyqtarë të larguar nga puna vijnë të paguheshin ose të punojnë në profesione ligjore. Pjesëmarrësit nënvizuan përpjekjet e vazhdueshme për të

arsimuar dhe ofruar trajnime për gjyqtarët dhe juristët, përmes shkollave të posaçme për përmirësimin e cilësisë dhe pavarësisë së profesioneve ligjore.

Një anketim i kohëve të fundit tregoi se sistemi i drejtësisë perceptohej nga qytetarët dhe aktorët ekonomikë si “relativisht i mirë”. Megjithatë, disa figura politike e kanë kritikuar sistemin gjyqësor dhe kanë mbrojtur publikisht individët e akuzuar për raste korrupsioni të profilin të lartë.

Shqipëria ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (2024-2030), e cila është një strategji ndërsektoriale e fokusuar në luftën kundër **korupsionit**. Megjithatë, mungojnë të dhënat publike për të gjurmuar progresin. Pjesëmarrësit rekomanduan që të përmirësohet monitorimi dhe të shpjegohet më mirë se si OShC-të mund të kontribuojnë në proces. Ka pasur evidenca të korrupsionit në projektet zhvillimore, si p.sh. digat te Parku Kombëtar i Vjosës dhe Aeroporti i Vlorës, të cilat shpeshherë kanë ardhur si pasojë e mungesës së transparencës dhe konsultimit. Pjesëmarrësit rekomanduan që Komisionit Evropian të përcaktojë tregues referencë për sundimin e ligjit në Kapitullin 27 - Mjedisi dhe ndryshimet klimatike.

Krijimi i **Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)** ka rezultuar në ndjekjen penale të disa zyrtarëve të nivelit të lartë. Pas shpërbërjes së Institucionit të Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre iu transferuan SPAK-ut. Pjesëmarrësit shprehën shqetësime mbi faktin se SPAK-u do të përballej me mbingarkesë. Ata rekomanduan miratimin e mekanizmave për të përshpejtuar llogaridhënien për zyrtarët e përfshirë në intimidimin e gjyqësorit. Përpjekjet kundër korrupsionit kanë qenë gjithashtu prioritet për autoritetet shqiptare, siç konstatohet nga miratimi i Strategjisë kundër Kundër korrupsionit.

Aksesi në drejtësi është penguar nga ulja e numrit të gjyqtarëve pas procesit të vetingut, çka ka shkaktuar procedura gjyqësore të tejzgjatura, në disa raste deri në 10 vite. Reformat e kohëve të fundit në sistemin gjyqësor, të cilat sollën miratimin e një harte të re gjyqësore dhe uljen e numrit të gjykatave, rritën më tej kufizimet në aksesin në drejtësi, në veçanti për personat me aftësi të kufizuara. Aksesin në drejtësi për personat e moshuar dhe romët u ndikua nga digjitalizimi i shërbimeve publike. Sipas pjesëmarrësve, statusi socio-ekonomik ishte gjithashtu një faktor i rëndësishëm. Nga ana e tyre, autoritetet shqiptare përmendën se rreth 70 vende vakante për magjistratët do të plotësoheshin brenda vitit 2026.

Në maj të vitit 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi Strategjinë e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura, por pjesëmarrësit besojnë se nuk janë marrë mjaftueshëm në konsideratë mekanizmat e **zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve**. **Klinikat ligjore** kanë marrë qindra kërkesa në vitin 2024, kryesisht lidhur me shkeljet procedurale dhe vonesat në gjykim. Gjithashtu, këto klinika kanë ndihmuar viktimat e dhunës në familje dhe të miturit në konflikt me ligjin. Edhe pse shërbimet e ndihmës juridike kanë kaluar nga modeli i financimit nga donatorët te modeli i financimit nga shteti, shtrirja dhe cilësia e tyre mbetet jo e njëtrajtshme. Pjesëmarrësit bënë thirrje që **ndërmjetësimi** të pranohet më tepër si një mjet efektiv për reduktimin e çështjeve të prapambetura. Autoritetet shqiptare konstatuan se po përpiqeshin të merrnin fonde për ndihmën juridike në kuadër të Planit të Rritjes të BE-së dhe Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor.

Për sa i përket **kushteve në burgje**, pjesëmarrësit përmendën mbipopullimin dhe nivelin e dobët të trajtimit mjekësor në qendrat e paraburgimit. Mungesa e profesionistëve të kujdesit mjekësor ka

shkaktuar raste të humbjes së jetës së të paraburgosurve, të cilat, sipas pjesëmarrësve, mund të evitoheshin, çka nënvizon mangësitë e thella institucionale. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e dënoi Shqipërinë në vitin 2007 për vendosjen në paraburgim të personave me probleme të shëndetit mendor si pasojë e mungesës së ambienteve të përshtatshme institucionale.

Pjesëmarrësin janë dakord me vlerësimin dhe rekomandimet e **Komisionit në Raportin për Sundimin e Ligjit 2024 për Shqipërinë**, si dhe shprehën besimin e tyre se qeveria i ka marrë në konsideratë disa rekomandime në hartimin e udhërrëfyesit për Kapitullin 24 - Drejtësia, liria dhe siguria. Megjithatë, OShC-të që kishin dhënë komente për raportin e mëparshëm për sundimin e ligjit, rekomanduan që të marrin komente nga delegacioni i BE-së lidhur me kontributin e tyre. Pjesëmarrësit kërkuan që t'u jepen më shumë detaje lidhur me fokusin që do t'i kushtohet tregut të përbashkët në raportin për sundimin e ligjit të Komisionit.

**Konstatimet e autoriteteve
mbi raportin për vizitën në Shqipëri,
2-3 prill 2025**

Konstatimet e qeverisë së Shqipërisë mbi draft raportin e Grupit për të Drejtat Themelore dhe Sundimin e Ligjit të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian për vizitën e tij në Shqipëri më 2-3 prill 2025.

Qeveria e Shqipërisë dëshiron të falënderojë Grupin për të Drejtat Themelore dhe Sundimin e Ligjit për diskutimet konstruktive të zhvilluara më 3 prill 2025 dhe dëshiron të paraqesë disa komente shtesë, në seksionet në vijim, lidhur me draftin e “Raportit për vizitën në Shqipëri më 2-3 prill 2025”. Qeveria e Shqipërisë beson se sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore janë parime bazë dhe të rëndësishme në një shoqëri demokratike dhe rrjedhimisht, mbështet punën e Grupit për të Drejtat Themelore dhe Sundimin e Ligjit dhe përpjekjet e tij për të nxitur respektin ndaj këtyre vlerave edhe në vendet candidate.

6. Të drejtat themelore të partnerëve sociale

Për sa i përket deklaratës se “punonjësit nuk kanë mjete juridike efektive kur largohen nga puna në mënyrë të padrejtë, pasi procedurat gjyqësore mund të zgjasin deri në 10 vite duke u mohuar kështu punonjësve mjetet juridike efektive,” **bazuar në statistikën e viteve të fundit, pavarësisht vendeve vakante në sistemin gjyqësor, nuk ka pasur çështje të regjistruara me kohëzgjatje deri në 10 vjet.** Për më tepër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar një vendim për të prioritetizuar gjykimin e çështjeve të lidhura me punën, i cili i ka kthyer në prioritet këto çështje nga viti 2020 e në vijim.

Gjithashtu, përmes miratimit të Vendimit nr. 433, datë 22.7.2025, “*Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve*”¹, sipas kreut II, pika 2, germa “c”, çështjet civile me objekt marrëdhënie pune parashikohen të kenë një kohëzgjatje standarde prej jo më shumë se 4 muaj.

7. Liria e organizimit dhe liria e tubimit

Për sa i përket deklaratës se “Shumë OShC janë përballur me pengesa ligjore dhe financiare, duke përfshirë vështirësi në regjistrim, mospërfshirje nga TVSH-ja dhe auditime/kontrolle shtetërore të vështira”, autoritetet shqiptare dëshirojnë t’ju informojnë se: OShC-të janë subjekt i një trajtimi specifik për qëllime të TVSH-së (përfshirje në import dhe TVSH zero brenda vendit) që nga viti 2023, në kuadër të projekteve të financuara me fonde nga grantet/donatorët, siç parashikohet në ligjin shqiptar për TVSH-në. Autoritetet shqiptare po vijojnë punën lidhur me rregullat e përkohshme dhe aktualisht është në proces rishikimi një Udhëzim i Ministrit të Financave për TVSH-në, me qëllim qartësimin e procedurave.

Për sa i përket deklaratës se: “Autoritetet shqiptare janë përgjegjës se gjatë katër viteve të fundit kanë zbatuar dy udhërrëfyes për të krijuar një mjedis mundësues për OShC-të dhe janë duke ndërmarrë hapa për të miratuar një udhërrëfyes të tretë”, autoritetet

1

<https://klgj.al/media/i0pfqfmh/vendim-nr-433-dat%C3%AB-22-07-2025-p%C3%ABr-p%C3%ABrcaktimin-e-afateve-standarde-minimale-kohore-dhe-standardeve-minimale-sasiore-p%C3%ABr-gjykimin-e-%C3%A7%C3%ABshtjeve.pdf>

shqiptare dëshirojnë të nënvizojnë se, në përputhje me angazhimet e ndërmarra në kuadër të procesit të integritetit në BE, më 2 tetor 2024 u miratua “Udhërrëfyeshi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, i cili përfshin një seksion të posaçëm me masa dhe angazhime konkrete që synojnë krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile.²

Për më tepër, për sa i përket konsultimit publik, nënvizojmë se, përpara miratimit të këtij Udhërrëfyeshi nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë organizoi 8 (tetë) tryeza konsultimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Gjithashtu, u dërguan mbi 58 komente nga OShC-të, shumica prej të cilave u morën në konsideratë në draftin përfundimtar të miratuar.

Dëshirojmë gjithashtu të nënvizojmë se më tepër se 35 OShC janë anëtare aktive në Platformën e Partneritetit për Integritetin Evropian për kapitullin 23 dhe kriterin “Funksionimi i Institucioneve Demokratike” të koordinuar nga Ministria e Drejtësisë. Këto organizata fokusohen në tema kyçe si të drejtat e njeriut, mosdiskriminimi, mbrojtja e fëmijëve, të drejtat e grave dhe lufta kundër korrupsionit.

8. Liria e shprehjes dhe liria e medias

Për sa i përket përqendrimit të pronësisë së mediave, ju informojmë se dispozitat ligjore që rregullojnë dhe që parandalojnë përqendrimin e pronësisë së mediave, të përfshira më parë në ligjin “Për mediat audiovizive”, janë shfuqizuar përmes Vendimit nr. 55/2016 të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, në përputhje me angazhimet e vendit në kuadër të procesit të integritetit evropian, më konkretisht me kapitullin 23 dhe treguesit e përkohshëm referencë të lidhur me këtë kapitull, Shqipëria pritet të shqyrtojë dhe të rishikojë kuadrin përkatës ligjor brenda vitit 2026.

Në të njëjtën kohë, transparenca lidhur me pronësinë e mediave në sektorin audioviziv garantohet aktualisht përmes buletineve vjetore që publikohen zyrtarisht nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në faqen e tij zyrtare të internetit. Një zhvillim i rëndësishëm në këtë aspekt është zbatimi i një mase të parashikuar në Udhërrëfyeshin për Shtetin e së Drejtës³. Duke filluar nga muaji mars 2025, çdo subjekt apo individ i interesuar do të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë formale pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të marrë informacion të plotë, duke përfshirë të dhëna mbi pronarët përfitues fundorë të subjekteve mediatike. AMA ka paraqitur grafikisht, në faqen e saj të internetit, transparencën e strukturës së pronësisë së shoqërive/individëve të licencuar/autorizuar nga AMA, si dhe deklaratën e pronarëve përfitues të këtyre subjekteve, në linkun në vijim <https://ama.gov.al/baza-e-te-dhenave-struktura-pronesore-e-oshma/>. Baza e të dhënave grafike, e cila është e publikuar në faqen zyrtare të internetit të AMA-s, është një model i përzgjedhur nga Rregullatorët Evropianë, më specifikisht nga ata portugezë, në kuadër të bashkëpunimit ekzistues ndërmjet

² VKM nr. 611, datë 2.10.2024, “Për miratimin e Udhërrëfyeshit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM-nr.-611-date-2.10.2024-Per-miratimin-e-Udherrefyeshit-per-Funksionimin-e-Institucioneve-Demokratike.pdf>

³ Qendra Kombëtare e Biznesit ka rritur monitorimin lidhur me zbatimin e ligjit “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të miratuar në vitin 2020, me synimin për të garantuar transparencë të plotë të pronarëve fundorë të subjekteve mediatike brenda vitit 2025, duke u fokusuar te subjektet mediatike në shkellje të kërkesave ligjore

autoriteteve të Shqipërisë dhe Portugalisë për shkëmbimin e praktikave më të mira institucionale dhe të politikëbërjes lidhur me transparencën e pronësisë së subjekteve të licencuara dhe/ose autorizuar për shërbimet audiovizive. Çdo NIPT (Numri i Identifikimit Tatimor ose Numri i Identifikimit të Personit të Tatuashëm) i subjekteve të licencuara dhe/ose të autorizuar i referohet të dhënave zyrtare nga ekstraktet e regjistruara dhe të deklaruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Është ndërmarrë një hap i rëndësishëm, pasi përmes bashkëpunimit ndërinstitucional me QKB-në, është krijuar tashmë një bazë e të dhënave financiare e subjekteve audiovizive. Kjo bazë e të dhënave përpilon të dhëna mbi veprimtaritë e tjera financiare të subjekteve të licencuara dhe/ose të autorizuar për veprimtari audiovizive. Informacioni i paraqitur në formë tabelore është një kontribut që së shpejti do të paraqitet edhe në formë grafike.

Shqipëria vazhdon të punojë ngushtësisht me ekspertët e Bashkimit Evropian dhe mban komunikim të rregullt me shërbimet e Komisionit Evropian për të garantuar harmonizim të plotë të kuadrit të saj ligjor me standardet e BE-së, duke përfshirë me Aktin Evropian për Lirinë e Medias (EMFA), Aktin për Shërbimet Digjitale dhe instrumentet e tjera përkatëse që trajtojnë çështjet e përqendrimit të mediave dhe pavarësisë së organeve rregullatore si AMA dhe transmetuesi publik RTSH.

Pas rikonfigurimit të komisioneve parlamentare, paketa legjislative për median, e cila përfshin gjithashtu rekomandimet e ardhura nga Platforma e Dialogut ndërmjet përfaqësuesve të mediave dhe institucioneve publike (e lançuar në janar të vitit 2025, me mbështetje nga fondet e BE-së dhe KE-së, si dhe në partneritet me Fakultetin e Gazetarisë), do të diskutohet më tej nga komisioni parlamentar kompetent. Ky proces synon të garantojë transparencë dhe gjithëpërfshirje në procesin e hartimit të ligjit.

Për sa u përket **masave anti-SLAPP**, Ministria e Drejtësisë ka kryer një analizë ligjore për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me Direktivën e re të BE-së. Për më tepër, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës parashikon ndryshimet e nevojshme ligjore për të harmonizuar plotësisht Kodin Civil dhe Kodin e Procedurës Civile me direktivën, brenda vitit 2026.

Për sa i përket çështjeve të lidhura me sigurinë e gazetarëve, vlen të përmendet se në çdo prokurori të juridiksionit të përgjithshëm janë caktuar 13 prokurorë për trajtimin e çështjeve të lidhura me median, si dhe 13 koordinatorë për të drejtën e informimit. Emrat dhe të dhënat e tyre të kontaktit janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës www.pp.gov.al. Prokuroria e Përgjithshme ka caktuar gjithashtu një pikë kontakti për raportimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe po zhvillon një bazë të dhënash për gjurmimin e këtyre rasteve. Këshilltari për median dhe koordinatori i informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme janë përgjegjës për përditësimin dhe publikimin e informacionit rreth këtyre rasteve.

Ka nisur bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me Policinë e Shtetit për të garantuar një koordinim në kohë reale të të dhënave ndërmjet institucioneve. Për më tepër, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj) ka caktuar një gjyqtar në çdo gjykatë për të vepruar si pikë kontakti për median, duke garantuar kështu transparencë dhe komunikim me publikun, në bashkëpunim me nëpunësit për marrëdhëniet me publikun.

Janë organizuar disa takime dhe tryeza të rrumbullakëta rreth temës “Përmirësimi i sigurisë dhe mbrojtjes së gazetarëve”, mbështetur në Platformën e Dialogut për Median. Janë duke u marrë masa vijuese për të ngritur një komision kombëtar si pjesë e fushatës “Gazetarët kanë rëndësi”.

Dëshirojmë të qartësojmë se **ndalimi i TikTok-ut** në Shqipëri ishte një masë e përkohshme, 12 mujore, e miratuar nga Qeveria e Shqipërisë përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave. Vendimi erdhi në vijim të një procesi të gjerë konsultimesh të realizuara në shkollat në mbarë vendin, ku u përfshinë mbi 65 000 prindër që nga nëntori i vitit 2024. Arsyeja kryesore në themel të kësaj mase ishte mbrojtja e interesave më të mirë të fëmijëve, veçanërisht pas humbjes tragjike të jetës të një adoleshenti në një shkollë në Tiranë.

Ky ndalim një vjeçar erdhi gjithashtu si rezultat i një dialogu konstruktiv ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe shoqërisë në pronësi të TikTok-ut, i cili kishte si synim garantimin e zbatimit të një sërë masash sigurie, ku përfshiheshin instrumentet mbrojtëse dhe për moderimin e përmbajtjes, të disponueshme në gjuhën shqipe, për të përmirësuar sigurinë e fëmijëve në këtë platformë.

9. E drejta për mosdiskriminim

Për sa i përket krimeve të urrejtjes

Dëshirojmë të qartësojmë se, prej disa vitesh tashmë, Shkolla e Magjistraturës realizon seanca trajnimi të fokusuara veçanërisht te çështjet e lidhura me krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes, me synim përmirësimin e gatishmërisë dhe ndërgjegjësimin të magjistratëve rreth këtyre çështjeve.

Për më tepër, Ministria e Drejtësisë, e cila shërben gjithashtu si pika kombëtare e kontaktit për Agjencinë e BE-së për të Drejtat Themelore (FRA) ka ofruar trajnim dhe u ka shpërndarë magjistratëve, në kohë reale, raporte të FRA-së për të rritur më tej ndërgjegjësimin.

Për më tepër, më 29–30 shtator 2025, Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë, në bashkëpunim me FRA-në, do të organizojë një seminar dyditor në Tiranë. Kjo ngjarje do të mbledhë bashkë magjistratë, oficerë policie dhe përfaqësues nga institucionet politikëbërëse në këtë fushë, me objektiv mbledhjen e të dhënave të ndara, duke përfshirë të të dhënave mbi krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes.

Gjithashtu, mund të konstatojmë se, që nga muaj korrik 2025, është në konsultim publik drafti i Kodit të ri penal, i cili përfshin dispozita specifike të posaçme për krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes që janë hartuar në përputhje me praktikën dhe modelet më të mira të BE-së.

Për sa i përket të drejtave të grave

Informacioni i paraqitur në diskutimet e mëparshme duket se bazohet kryesisht në perceptime dhe jo në prova të arsyetuara. Në veçanti, dëshirojmë të nënvizojmë se, sipas statistikave zyrtare për aksesin në ndihmën juridike falas, një analizë krahasuese e periudhës 2020–2024 tregon një nivel aksesin të qëndrueshëm dhe të lartë të grave në shërbimet juridike.

Më konkretisht:

- Në vitin **2021**, gratë përbënin **65%** të përfituesve të ndihmës juridike dytësore dhe **60%** të përfituesve të ndihmës juridike parësore. **86%** e rasteve të ndihmës juridike dytësore që përfshinin gratë kishin të bënin me çështje civile, **7%** me çështje penale dhe **7%** me çështje administrative.
- Në vitin **2022**, gratë përbënin **58%** të përfituesve të ndihmës juridike dytësore, dhe **61%** e rasteve ishin objekt i të drejtës civile, **33%** i të drejtës administrative dhe **6%** i të drejtës penale.
- Në vitin **2023**, gratë përbënin **70%** të përfituesve të ndihmës juridike dytësore dhe rastet e lidhura me të drejtën civile përbënin sërish shumicën me **84%**.
- Kjo tendencë ka vijuar edhe në vitin **2024**, çka tregon një akses të qëndrueshëm të grave në shërbimet e ndihmës juridike.

Për më tepër, theksojmë se pjesëmarrja e grave në politikë në Shqipëri është rritur ndjeshëm. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura më **11 maj 2025**, u zgjodhën si deputete **49 gra**, nga 140 në total, gjë që do të thotë se niveli kombëtar i pjesëmarrjes së grave është **35,7%**, një shifër që tejkalon **mesataren e BE-së prej 33,1%**.

Për më tepër, në kabinetin e ri qeveritar, **8 nga 15 ministri** udhëhiqen nga gra që mbajnë portofola ministrorë, çka pasqyron më tej progresin e Shqipërisë në nxitjen e barazisë gjinore në udhëheqjen politike dhe institucionale.

10. Sundimi i ligjit

Për sa i përket **aksesit në drejtësi**, dëshirojmë të sqarojmë se pas miratimit të hartës së re gjyqësore, Ministria e Drejtësisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të ngritur qendra të ndihmës juridike në çdo qark, duke përfshirë në ato qarqe ku u mbyllën gjykatat. Për rrjedhojë, nga 14 qendra të ndihmës juridike në vitin 2022, në dhjetor të vitit 2024 kishte 20 qendra të ndihmës juridike në total, nga të cilat 14 janë të financuara nga shteti dhe 6 operojnë me mbështetjen e UNDP-së.

Për sa i përket konfirmimit se **kohëzgjatja e procedurave gjyqësore mund të shtrihet deri në 10 vite**, dëshirojmë të sqarojmë se edhe pse në disa raste tejkalohen afatet kohore ligjore, të dhënat më të fundit bazuar në metodologjinë e CEPEJ, duke marrë në konsideratë se ka përfunduar faza e parë e procesit të vetingut dhe se po plotësohen gradualisht vendet vakante në sistemin gjyqësor, shfaqin një kohëzgjatje mesatare prej 190 ditësh për çështjet në gjykatat e shkallës së parë. Megjithatë, në shkallët më të larta konstatohen kohëzgjatje më të mëdha. Më konkretisht, kohëzgjatja mesatare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 1546 ditë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit është 3276 ditë.

Aktualisht, Shqipëria ka 14 qendra të ndihmës juridike falas, 12 klinika ligjore të lidhura me universitetet, 15 OJQ të autorizuar që ofrojnë ndihmë juridike falas dhe 177 juristë që ofrojnë ndihmë juridike dytësore.

Për sa i përket nxitjes së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM), theksojmë se strategjia e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura e Këshillit të Lartë Gjyqësor është

pasuar nga Vendimi nr. 407, datë 15 korrik 2025, i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGj), “Për miratimin e Udhërrëfyesit për efikasitetin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri 2025–2027.”⁴”

Objektivi 1.4 i këtij Udhërrëfyesi trajton në mënyrë specifike përdorimin e mekanizmit të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, siç rekomandohet në dokumentet e politikave dhe standardet ndërkombëtare, si një mënyrë për të zvogëluar ngarkesën e çështjeve në gjykata. Në veçanti, zbatimi i veprimtarive në kuadër të objektivit 1.4 do të udhëhiqet nga programi i ndërgjegjësimit i CEPEJ mbi ndërmjetësimin për gjyqtarët, me titull “*Sigurimi i efikasitetit të referimit gjyqësor në ndërmjetësim.*”

Për sa i përket paragrafit të fundit lidhur me Raportin për Sundimin e Ligjit 2024, theksojmë se institucionet shqiptare kanë qenë proaktive dhe kanë siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm duke iu përgjigjur në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha pyetësorëve dhe verifikimeve faktike, në përputhje me metodologjinë për përgatitjen e Raporteve për Sundimin e Ligjit për vitet 2024 dhe 2025.

Gjithashtu, konstatojmë se Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës, i cili mbulon çështjet e Kapitullit 23 (Gjyqësori, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore) dhe Kapitullit 24 (Lufta kundër krimit të organizuar, bashkëpunimi gjyqësor, migrimi dhe politika e vizave), është hartuar në dhjetor të vitit 2023, gjatë muaj përpara publikimit të Raportit për Sundimin e Ligjit 2024. Udhërrëfyesi është bazuar në një raport vlerësues (screening) që i është dorëzuar Shqipërisë për klusterin 1 në korrik 2023, dhe nënvizon angazhimet formale të Shqipërisë dhe piketat në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin në BE.

Për sa i përket **konfirmimit të kushteve në burgje dhe përmendjes së problematikës së mbipopullimit nga pjesëmarrësit**, dëshirojmë të qartësojmë se sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nga janari i vitit 2025, popullata në burgjet në Shqipëri përbën 84%, të kapacitetit, shifra më e ulët në pesë vitet e fundit.

Për më tepër, burgjet në Shqipëri janë të pajisur me personal mjekësor dhe infermierë që ofrojnë kujdes shëndetësor për të paraburgosurit dhe të burgosurit. Gjithashtu, Shqipëria dëshiron të zbatojë rekomandimet e dhëna nga Komiteti kundër Torturës (CPT) gjatë vizitës së tij të fundit në vend në janar 2024.

4

<https://klgj.al/media/ixhzn2ut/vendim-nr-407-dat%C3%AB-15-07-2025-mbi-miratimin-e-udh%C3%ABrr%C3%ABfyesi-p%C3%ABr-efikasitetin-e-pushtetit-gjyq%C3%ABsor-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2025-2027.pdf>



Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian

Rue Belliard/Belliardstraat 99
1040 Bruxelles/Brussel
BELGIQUE/BELGIË

www.eesc.europa.eu



Printed by the EESC-CoR Printing and Distribution Unit, Belgium

EESC-2025-61-SQ

© European Union, 2025

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.
For any use or reproduction of the photos / illustrations,
permission must be sought directly from the copyright holder.



Publications Office
of the European Union



Print:
QE-01-25-040-SQ-C
ISBN 978-92-830-6953-9
doi:10.2864/3230955
PDF:
QE-01-25-040-SQ-N
ISBN 978-92-830-6952-2
doi:10.2864/0979640

SQ